



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

VENDIM
Nr. 24 Datë 24.11.2020

PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATIT ZJ. EGLANTINA NEVRUS GJOSHI NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË GJELBËR, PËR KËSHILLIN E BASHKISË BELSH, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, pika 1, germa “n” dhe pika 2 e Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 11 i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; Kreu V i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur;

VËREN

Me shkresën nr. 2363 prot., datë 31.08.2020, Këshilli i Bashkisë Belsh ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga Këshilltari, z. Avni Tele Shtylla, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2, i Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1517/2 prot., datë 14.10.2020, i është drejtuar z. Marenglen Kamer Bali, me kërkesë për plotësim dokumentacioni, si kandidat vijues i listës shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Belsh, të cilit i kalon mandati i këshilltarit. Ky kandidat nuk ka depozituar formularin e vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.



rezulton se lista e kandidatëve të Partisë Socialiste të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Belsh, ka shteruar. Sipas nenit 164, pika 4, të Kodit Zgjedhor, në rast se lista e kandidatëve të partisë politike, anëtare e një koalicioni ka shteruar, mandati i kalon partisë së koalicionit me herësin më të lartë.

Partia Socialiste ka fituar 18 mandate, Partia Gjelbër ka fituar 1 mandat, Partia Social Demokrate ka fituar 1 mandat dhe Partia Ora e Shqipërisë ka fituar 1 mandat. Sipas nenit 163/2 të Kodit Zgjedhor, numri i votave të vlefshme të secilës parti të Koalicionit, pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë tek të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror që i korrespondon dyfishit të numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore përkatëse për koalicionin në fjalë.

Herësi i përfutur nga çdo pjesëtim, renditet. Rezulton se brenda koalicionit, partia me herësin më të madhe është Partia Gjelbër me 143 vota.

Referuar vendimit të Kolegjit Zgjedhor nr. 75, datë 26.07.2019 “Për shpërndarjen e mandateve për Këshillin e Bashkisë Belsh për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore 2019, si dhe në bazë të nenit 164, pika 4, i Kodit Zgjedhor, herësi më i lartë brenda koalicionit i takon subjektit politik Partia Gjelbër.

Në këto kushte mandati i ndërprerë i z. Marenglen Kamer Bali me numër rendor 20, i kalon Partisë Gjelbër.

Në bazë të nenit 164 pika 2, i Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, procedon me kandidatin vijues të listës shumemërore të subjektit politik Partia Gjelbër, Bashkia Belsh, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, me numër rendor 02, zj. Eglantina Nevrus Karaj.

Referuar nenit 11 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar përcaktuar në bazë të listës shumemërore të subjektit politik Partia Gjelbër, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit me numër 0050 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.



Nr. 24 i vendimit

Data 24.11.2020 e vendimit

“Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit zj. Eglantina Nevrus Gjoshi nga lista shumemërore e Partisë Gjelbër për këshillin e bashkisë Belsh, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për anëtar zj. Eglantina Nevrus Gjoshi, në këshillin e bashkisë Gjirokastrë, rezulton se: Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjenealitete të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjenealitetet e saj dhe është shprehur se ka ndryshuar mbiemrin nga “Karaj” në “Gjoshi”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, germa “b” dhe pika 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, me shkresën nr. 2007 prot., datë 12.11.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2008 prot., datë 12.11.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar zj. Eglantina Nevrus Gjoshi, në Këshillin e Bashkisë Belsh, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës tonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar në këshillin e bashkisë Belsh, zj. Eglantina Nevrus Gjoshi.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore me shkresën nr. 11650/1 prot., datë 17.11.2020 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar zj. Eglantina Nevrus Gjoshi, në këshillin e bashkisë Belsh, e cili rezulton me status e padënuar nga gjykatat shqiptare.

Referuar nenit 49 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” këshilli i bashkisë ka kompetencën për dhënien e mandatit, anëtarit të këshillit bashkiak.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, Kreu V të vendimit nr.17/2016 të Kuvendit konstaton se, për kandidatin për anëtar zj. Eglantina Nevrus Gjoshi, në këshillin e bashkisë Belsh, të dhënat e të cilit nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit, duhet të vazhdojnë procedurat për dhënie mandati nga këshilli i bashkisë Belsh.



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, germa “n” dhe pika 2 e Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 11 i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; Kreu V i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

VENDOSA:

1. Zj. Eglantina Nevrus Gjoshi, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Belsh, e subjektit politik Partia Gjellbër, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Vazhdimin e procedurave nga këshilli i bashkisë Belsh, për dhënien e mandatit, kandidatit të listës shumëmemërore zj. Eglantina Nevrus Gjoshi, e subjektit politik Partia Gjellbër, për plotësimin e vendit vakant në Këshillin e Bashkisë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Ilirjan CELIBASHI



Nr. 24 i vendimit

Data 24.11.2020 e vendimit

“Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit zj. Eglantina Nevrus Gjoshi nga lista shumëmemërore e Partisë Gjellbër për këshillin e bashkisë Belsh, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.